



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 179 Datë 28.12.2012

**PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLAT E TREGUT
SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neni 112, pika 2 germa a) i Ligjit 8485, date 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Admisnitrative”, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, te ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të dates 28.12.2012, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorive Teknike për një ndryshim në Rregullat e TregutShqiptar të Energjisë Elektrike,

Vendosi:

1. Pika 2 e Vendimit 93, date 16.07.2012, te Bordit te Komisionereve te ERE, ndryshohet si me poshte:

Ky vendim do ti shtrije efektet deri ne 31 Janar 2013.

2. Ne Kapitullin IX pika 1.3.c, te ndryshohet si vijon:

“Gjeneruesit e energjise elektrike do të jenë objekt i disbalancave sipas dispozitës së më sipërme.

Për gjeneruesit që janë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes disbalancat do të llogariten me matje. (aparaturat matës).

Për gjeneruesit që janë të lidhur në rrjetin e transmetimit disbalancat do të llogariten me matje, duke filluar që nga data 1 Shkurt 2013.

KESH (Gen) në cilësinë e siguruesit të balancimit nuk është subjekt i trajtimit të disbalancave, duke filluar nga data 1 Gusht 2012.

FPSH referuar Modelit të Tregut, pika 6, nuk do të jetë subjekt i trajtimit të disbalancave, duke filluar nga data 1 Gusht 2012.”

Ne Kapitullin IX, pika 1.3.d, fjalë e fundit, ndryshon dhe behet si vijon:

HEC-et e Vegjël të lidhur në rrjetin e shpërndarjes nuk do të jenë subjekt i trajtimit nga disbalancat deri deri në 31 Qershor 2013.

3. Ngarkohet Drejtoria e Juridike dhe e Mbrotjtes se Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI